**BASHKIA E TIRANËS**
K R Y E T A R I
**U R DH Ë R**

Nr. 29662, datë 05.10.2016

**Për**

**"Përcaktimin e listës së shërbimeve që u jepen qytetarëve nga Njësitë Administrative dhe/ose strukturat e Aparatit të Bashkisë së Tiranës dhe ndarje e detyrave në lidhje me to"**

Me qëllim ofrimin e shërbimeve sa më pranë qytetarëve dhe përcaktimin e listës së shërbimeve që do t'u ofrohen qytetarëve nga administra e aparatit të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe administrata e njësive administrative, për shërbime për të cilat është kompetente Bashkia e Tiranës dhe në mbështetje të nenit 2, pika 12, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja "b", nenit 32, , nenit 64 shkronja "a", nenit 66, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës nr. 3017, datë 29.01.2016 dhe Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 18953, datë 20.06.2016, për " Miratimin e strukturës dhe organikës përfundimtare të aparatit të Bashkisë së Tiranës",

**URDHËROJ:**

1. Ndarjen e detyrave/përgjegjësive mes Administratës së Njësive Administrative dhe strukturave përgjegjëse të Aparatit të Bashkisë së Tiranës, të cilat duhet të japin shërbimet ndaj qytetarëve sipas listës së përcaktuar në Aneksit 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Administratori/administrata e Njësive Administrative dhe strukturat e Aparatit të Bashkisë së Tiranës të kryejnë të gjitha veprimeve e domosdoshme për pëmbushjen e plotë të shërbimit të kërkuar konform ligjit, praktikës me të mirë administrative dhe Aneksit 1, kjo deri në momentin që do të detajohen dhe zbardhen e procedurat përkatëse të punës në lidhje me to.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Zhvilimit të Marrëdhënieve me Komunitetin dhe Njësitë Administrative për detajimin e procedurave të punës në zbatim të pikës 1 dhe 2 të këtij urdhëri.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore për njoftimin e këtij urdhri strukturave të ngarkuara në pikën 1 të këtij urdhëri.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen administrata e Njësive Administrative dhe/ose strukturat përgjegjëse të Aparatit të Bashkisë së Tiranës.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

**Erion VELIAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA TIRANË

| Nr. | **Lista e shërbimeve sipas fushave te pergjegjesise** | **Organ i Autorizues/Nenshkrues** |
|---|---|---|
| 1 | **TRANSPORTI** | |
| **1.1** | Pajisje me Licencë për miratimin e Agjencisë së transportit të udhëtarëve brenda vendit dhe taksi | **Kryetari i Bashkise se Tiranes** |
| **1.2** | Pajisje me Licencë për miratimin e Agjencisë së transportit ndërkombëtar të udhëtarëve | **K** |
| **1.3** | Pajisje me Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse | **K** |
| **1.4** | Pajisje me Licencë për transportin e udhëtarëve me autobus në linjën ndërqytetëse brenda dhe jashtë qarkut | **K** |
| **1.5** | Pajisje me Licencë për transport udhëtarësh me taksi 4+1 dhe 8+1 | **K** |
| **1.6** | Pajisje me Licencë dhe Certifikatë për transport malli për të tretë dhe me qera brenda vendit | **K** |
| **1.7** | Pajisje me Leje për transport qytetës udhëtarësh me autobus | **K** |
| **1.8** | Pajisje me Autorizim qarkullimi brenda unazës së qytetit | **K** |

| | | |
|---|---|---|
| 1.9 | Pajisje me Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet | K |
| 1. 10 | Pajisje me Leje vendparkimi të rezervuar me pagesë për individë, biznese, institucione shteterore | K |
| 1.11 | Pajisje me Leje vendparkimi të rezervuar për personat me aftësi të kufizuar | K |
| 1.12 | Pajisje me Certefikatë për transport udhëtarësh për llogari të vet brenda vendit | K |
| 1.13 | Pajisje me Leje për veprimtari shërbimi në fushën e transportit për shërbim në rrugë, larje automjetesh, parkim, gomisteri, shërbime të ndryshme për automjetet ) | K |
| 1.14 | Pajisje me Konfirmim oraresh të nisjes nga qyteti i Tiranës për linjat ndërqytetëse me pikë fundore këtë të fundit | K |
| 1.15 | Pajisje me Autorizim i lëvizjes jashtë linjës pa ndalesë (për ndalim qarkullimi) | K |
| 1.16 | Pajisje me Leje kalimi kundër sinjalit rrugor, ndalim qarkullimi të përkohshëm. | K |
| 1.17 | Pajisje me Dublikate per Licence/Certifikate/Autorizim | K |
| 1.18 | Pajisje me Licencë/Certefikatë për rinovim dhe ndryshim/shtim mjeti | K |
| 2 | **HAPËSIRA PUBLIKE** | |
| 2.1 | Paiisje me leje për ofrimin e sherbimeve restorative dhe/ose rekreative | K |
| 2.2 | Pajisje me leje per zhvillimin e aktiviteteve ambulatore | K |
| 2.3 | Pajisje me leje për ekspozimin e mallrave jashte njesise se tregtimit | K |
| 2.4 | Pajisje me leje për zhvillimin e panaireve | K |

| | | |
|---|---|---|
| 2.5 | Pajisje me leje për zhvillimin e aktiviteteve argetuese, kulturore dhe manifestimet politike etj. | K |
| 2.6 | Pajisje me leje për hapesirat reklamuese (Citylights) | K |
| 3 | **KARBURANTI** | |
| 3.1 | Pajisje me licencë për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit të lëngshëm të naftës për veprimtari tregtimi përdorim rezidencial. | K |
| 3.2 | Pajisje me licencë për stacion shitje karburantesh, gazit të lëngshëm të naftës për automjete dhe vajra lubrifikante. | K |
| 4 | **PLANIFIKIMI I TERRITORIT** | |
| 4.1 | Informim në lidhje me zhvillimin e pronës sipas PPV apo PDV | A |
| 4.2 | Hartimi i PDV-ve (Bashki ose privat) | K |
| 4.3 | Hartime genplan i azhornuar i pronës (genplane për leje zhvillimi, genplane për deklarime paraprake) | K |
| 4.4 | Konfirmim për vijën kufizuese të qytetit të Tiranës | A |
| 4.5 | Konfirmim për adresë banese apo institucione (adresari) | A |
| 4.6 | Leje zhvillimi | K |
| 4.7 | Deklaratë për kryerje punimesh | K |

| | | |
|---|---|---|
| 4.8 | Leje ndërtimi<br>(**a.** ndërtim i ri, **b.** rikonstruksion/riparim/restaurim që çon në ndryshim të vëllimit, sipërfaqes, pamjes, përdorimit ose sistemit konstruktiv, **c.** Mirëmbajtje e jashtëzakonshme me ndryshime të sistemit konstruktiv, **d.** prishja e objekteve që nuk shoqërohet me ndërtim të ri) | **K** |
| 4.9 | Ndryshim i aktiviteteve/funksioneve (destinacioni) | **K** |
| 4. 10 | Rishikim i kushteve të lejes së ndërtimit | **K** |
| 4.11 | Shtyrja e afatit të lejes së ndërtimit | **K** |
| 4.12 | Ndryshimi i subjektit zbatues | **K** |
| 4.13 | Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet që shqyrtohen në KKT | **K** |
| 4.14 | Informacion ne lidhje me lejet e ndertimit te miratuara deri ne konstituimin e organeve perfaqesuese dhe ekzekutive te Bashkise Tirane pas zgjedhjeve te vitit 2015 | **A** |
| 4.15 | Informacion ne lidhje me aktet e kontrollit per lejet e ndertimit te miratuara deri ne konstituimin e organeve perfaqesuese dhe ekzekutive te Bashkise Tirane pas zgjedhjeve te vitit 2015 | **A** |

| | | |
|---|---|---|
| **4.16** | Aktet e kontrollit te fazave te ndertimit (**a.** ngritja e kantierit të punimeve, **b.** piketimi i objektit, kuota ± 0.00m, **c.** kontrolli i karabinase, **d.** kontrolli i fasadave dhe rifiniturave, **e.** sistemimet e jashtme) | **K** |
| **4.17** | Pajisje me çertifikatë përdorimi | **K** |
| **5** | **TOKA** | |
| **5.1** | Paisje me vërtetim mbi përcaktimin e kategorisë së tokës bujqësore | **A** |
| **5.2** | Pajisje me vërtetim që ka qënë anëtar i ish kooperativës bujqësore deri më 01 Gusht 1991 | **A** |
| **5.3** | Paisje me vërtetim që ka qenë banor i ish ndërmarrjes bujqësore 01/10/1992 | **A** |
| **5.4** | Pajisje me vërtetim të tokës në pronësi/përdorim | **A** |
| **5.5** | Pajisje me vërtetim për ushtrim aktiviteti bujqësor dhe blegtoral | **A** |
| **5.6** | Pajisje me aktin e marrjes së tokës në pronësi | **K** |
| **5.7** | Pajisje me vërtetim për pagesën e taksës për tokën bujqësore dhe ndërtesën | **Administratori i Njesise Administrative, DPTTV** |
| **5.8** | Përcjellje dokumentacioni mbi studimin dhe përcaktimin e kategorisë së tokës | **A** |
| **5.9** | Paisje me deklaratë kufitarësh | **A** |
| **5.10** | Paisje me vërtetim që është furnizuar me tokë (për efekt dalje jashtë kufijve) | **A** |

| | | |
|---|---|---|
| **5.11** | Paisje me vërtetim që nuk është furnizuar me tokë bujqësore | **A** |
| **5.12** | Paisje me vërtetim Akt-Shitje, për herë të parë. | **A** |
| **5.13** | Dergim dokumenatcioni per regjistrim, korigjim dhe saktësim të tokës bujqësore. | **K** |
| **5.14** | Dergim dokumentacioni per regjistrim toke troje | **K** |
| 6 | **PRONA** | |
| **6.1** | Dhënie me qera e aseteve të Bashkisë për sipërfaqe nën 200 $m^2$ | **K** |
| **6.2** | Dhënie me qera e aseteve të Bashkisë për sipërfaqe mbi 200 $m^2$ | **K** |
| **6.3** | Dhënie me qera e aseteve të Bashkisë për pajisje teknologjike | **K** |
| **6.4** | Dhënie me enfiteozë e aseteve të Bashkisë | **K** |
| **6.5** | Pajisje me konfirmim kufizim pronë private me pronë shtet | **A** |
| **6.6** | Pajisje me vërtetim trajtimi me tokë (arrë) sipas ligjit nr. 7501 | **A** |
| **6.7** | Pajisje me konfirmim për pronat e Bashkisë (për oborr në përdorim) | **K** |
| **6.8** | Pajisje me konfirmim për pronat e Bashkisë | **K** |
| **6.9** | Pajisje me konfirmim për pronat e transferuara Bashkisë për efekt të privatizimit të objektit | **K** |
| **6.10** | Pajisje me konfirmim për pronat e Bashkisë për efekt të privatizimit të truallit | **K** |
| 7 | **STREHIMI** | |

| | | |
|---|---|---|
| 7.1 | Përfitim nga programet e strehimit social | K |
| 7.2 | Aplikim për të konfirmuar formularin e strehimit të ardhur nga Njësia Administrativedhe rregjistruar në sisitemin elektronik të drejtorisë, si i pastrehë | K |
| 8 | **SHËRBIMI SOCIAL** | |
| 8.1 | Aplikim për përfitim burse studimi brenda vendit | A |
| 8.2 | Aplikim për përfitim ndihme ekonomike | A |
| 8.3 | Aplikim për përfitim pagese për paraplegjikë dhe tetraplegjikë | A |
| 8.4 | Aplikim për përfitim pagese për verbërinë | A |
| 8.5 | Aplikim për përfitim pagese për shtesë invaliditeti | A |
| 8.6 | Aplikim për përfitim pagese për aftësi ndryshe | A |
| 8.7 | Pajisje me vërtetim pagese për aftësi ndryshe | A |
| 8.8 | Aplikim për përfitim ndihme ekonomike për shërbim kujdestarie për të mitur | A |
| 8.9 | Aplikim për përfitim pranimi i personave me aftësi ndryshe në institucionet rezidenciale | A |
| 8. 10 | Përfitim pranimi i personave të moshuar në institucionet rezidenciale ditore | A |
| 8. 11 | Pajisje me vërtetim të të ardhurave ekonomike | A |
| 8. 12 | Pajisje me vertetim për pension | A |
| 8. 13 | Pajisje me vërtetim për takim në burg | A |

| | | |
|---|---|---|
| **8. 14** | Pajisje me vlerësim moralo-shoqëror | **A** |
| **8. 15** | Aplikimi për përfitim kompesimi të energjisë elektrike të kategorisë së Para/Tetraplegjikëve dhe të Verbërve. | **A** |
| **8. 16** | Përfitim shërbimi biblotekar | **A** |
| **8. 17** | Pajisje me vërtetim llogarie bankare për invaliditet dhe paaftësi | **A** |
| **8. 18** | Pajisje me vërtetim për personat që vuajnë dënimin në IEVP | **A** |
| **8. 19** | Pajisje me vërtetim banimi si banor lagjie personit që jeton jashtë kufirit shqiptar | **A** |
| **8. 20** | Paisje me vërtetim për pensionistët që jetojnë vetëm | **A** |
| **8. 21** | Pajisje me vërtetim banimi të bashkëshortëve më vete (përfitim i kompesimit të OSSHE) | **A** |
| **8. 22** | Aplikim për përfitimi i shpërblimit të lindjes | **K** |
| **8. 23** | Përfitimi i mbrojtjes së të miturve | **A** |
| 9 | **SHËRBIMI PUBLIK I VARRIMIT** | |
| **9. 1** | Pajisje me autorizim per transportimin e kufomave | **K** |
| **9. 2** | Pajisje me leje zhvarrimi | **K** |

| | | |
|---|---|---|
| 9. 3 | Pajisje me leje varrimi | K |
| 10 | **EMERGJENCA CIVILE** | |
| 10. 1 | Përfitim ndihme financiare në rast fatkeqësie natyrore | K |
| 11 | **ARKIVA** | |
| 11.1 | Pajisje me fotokopje dokumenti arkivor qe gjendet prane njesive | A |
| 12 | **ZYRA E GJENDJES CIVILE** | |
| 12. 1 | Çertifikatë lidhje martese midis dy shtetasve shqiptarë | A |
| 12.2 | Çertifikatë lidhje martese midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj | A |
| 12. 3 | Certifikatë lidhje martese midis dy shtetasve të huaj | A |
| 12. 4 | Çertifikatë akt-martese, akt-lindje dhe akt vdekje për jashtë shtetit brenda vitit | A |
| 12. 5 | Pajisje me Çertifikate te trungut familjar nga vitet 1923 - 1930, 1930 - 1945, 1945 - 1950, 1950 - 1974. | K |
| 12. 6 | Paisje me Procesverbal për njohje atësie | A |
| 12. 7 | Paisje me Procesverbal për bashkim familjar | A |
| 12. 8 | Paisje me Procesverbal për veçim familjar | A |
| 12. 9 | Pajisje me Certifikate te trungut familjar pas vitit 1974, nga Regjistri Kombetar i Gjendjes Civile | A |
| 12. 10 | Regjistrimi i lindjeve pranë Zyrës së Gjendjes Civile | A |
| 12. 11 | Çregjistrimi i të vdekurve nga Gjendja Civile | A |
| 12. 12 | Vërtetetim i njëjti person | A |

| | | |
|---|---|---|
| **12. 13** | Çertifikatë personale | **A** |
| **12. 14** | Çertifikatë familjare | **A** |
| **12. 15** | Çertifikatë martese brenda vitit | **A** |
| **12. 16** | Transferimi i njësisë administrative, pajisje me kod banese | **A** |
| **12. 17** | Pajisje me certifikatë nga arshiva e Gjendjes Civile për aktet e mbajtura në Rregjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile pas vitit 2009 | **K** |
| **12. 18** | Pajisje me certifikatë për aktet e lindjes, marteses vdekjes te mbajtura brenda vitit | **A** |
| 13 | **KULTURA** | |
| 13. 1 | Përftim për mbështetje financiare për projekte artistiko-kulturore | **K** |
| 14 | **PROCEDURA ANKIMIMI** | |
| **14.1** | Ankim administrativ ndaj gjobave të vendosura nga BT | **K** |
| 15 | **BANIM** | |
| **15.1** | Paisje me vërtetim banor njësie administrative - banorë të përhershëm | **A** |
| **15.2** | Paisje me vërtetim banor njësie administrative - banorë të përkohshëm | **A** |
| **15.3** | Pajisje me vërtetim aplikimi për legalizim ndërtimi pa leje per aplikimet qe jane bere ne sportelet e ngritura prane njesive. | **A** |

| | | |
|---|---|---|
| 15.4 | Vertetim për dosje vetdeklarimi të ndërtesave të tipit A dhe A1 të cilat janë plotësuar nga viti 2006 ne sportelet e ngritura prane tyre. | A |
| 16 | **FINANCA** | |
| 16.1 | Pajisje me vërtetim page | K |
| 17 | **BURIME NJERËZORE** | |
| 17.1 | Pajisje me vërtetim vjetërsie në punë | A |
| 17.2 | Pajisje me vërtetim nga njësia administrative për mungesë dokumentacioni në lidhje me vjetërsinë në punë para vitit 1990 për dokumentacionin i cili | A |
| 18 | **BASHKËPRONËSIA** | |
| 18.1 | Pajisje me vendim të mbledhjes së asamblesë së bashkëpronarëve/KB | A |
| 18.2 | Regjistrim në regjistrin e bashkëpronësisë/emrat e anëtarëve të kryesisë dhe adresën e ndërtesës së banimit. | A |
| 18.3 | Regjistrim në librin e administratorëve, pranë bashkisë, në juridiksionin e së cilës do ta ushtrojë këtë veprimtari. | A |
| 18.4 | Kërkesë për kontraktimin e administratorit ose shoqërie administruese nëse:a)një asamble bashkëpronarësh nuk konstituohet;b)një asamble nuk merr vendim për formën e administrimit brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. – Kryetari i Bashkisë. | A |
| 20.2 | **Legjenda** | |
| 21 | A = Administrator i Njesise Adiministrative | |
| 21.1 | K = Kryetari i Bashkise Tirane | |